

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-173/14**

**Prishtinë,**  
**23 mars 2016**

Në çështjen juridike të:

**V.S.B.**

Rruga “Rendgenova” 13  
Medijana, Nish  
Serbi

***Pala ankuese***

**Kundër**

**S.H.**

Mushtisht  
Suharekë

***Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA31478), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 23 mars 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e V.S.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014, të datës 13 mars 2014, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin 31478.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/231/2014, i datës 13 mars 2014, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin 31478.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 18 korrik 2007 V.S.B. (në tekstin e mëtejme: Paraqitësja e kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe ri-posedim lidhur me banesën me sipërfaqe prej 42,22 m<sup>2</sup> që gjendet në Ulpianë D7, Hyrja e 2-të, nr. 25, Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Kërkesa ishte bërë nga paraqitësja e kërkesës si anëtare e familjes së burrit të saj, Z.G.B., i cili ishte cekur si Bartësi i së Drejtës Pronësore (në tekstin e mëtejme: BDP) në banesën e kërkuar.

Në kërkesë theksohet se banesa e kërkuar ishte humbur për shkak të rrethanave që ndërlihdhen me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999, ku përmendet data 17 qershor 1999 si data e humbjes dhe e njëjta është e uzurpuar nga S.H. .

2. Me kërkesën e saj paraqitësja e kërkesës kishte dorëzuar *inter alia*:
  - Certifikatën e kurorëzimit nr. 202, të datës 25 qershor 1996, të lëshuar nga Republika e Serbisë. Sipas këtij dokumenti paraqitësja e kërkesës është gruaja e BDP-së;
  - Listën prioritare për ndarjen e “banesës” nr. 01-2094/1, të datës 16 korrik 1996. Në listë gjendet emri i BDP-së (ky dokument nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar nëse kjo listë i referohet banesës së kërkuar);
  - Pasqyrën e listës prioritare për ndarjen e banesave të Ndërmarrjes Publike Banësore (NPB) nr. 01-432/1-4, të lëshuar nga Komisioni i NPB-së më 16 shkurt 1999. Ky dokument paraqet emrin e BDP-së dhe adresën e banesës së kërkuar (nën numrin 4);

- Vendimin nr. 01-432/1-4, të datës 18 shkurt 1999, të lëshuar nga Komisioni i NPB-së. Sipas këtij dokumenti ndarja e banesave mund të bëhet për punëtorët e NPB-së, në përputhje me listën e përcaktuar të radhitjes në bazë të prioritetit;
  - Vendimin e ndarjes nr. 01-476/1, të datës 18 shkurt 1999, të lëshuar nga NPB-ja. Sipas këtij dokumenti banesa e kërkuar pretendohet t'i jetë ndarë BDP-së;
  - Kontratën mbi qiradhënien e banesës së kërkuar, të datës 19 shkurt 1999. Kjo kontratë është lidhur në mes të NPB-së dhe BDP-së. Kontrata thekson se BDP (si qiramarrës) do ta shfrytëzoj banesën së bashku me anëtarët e familjes së tij (emri i paraqitëses së kërkesës përmendet si i pari në mesin a anëtarëve të tjerë të familjes);
  - Kontratën (e verifikuar) të blerjes Ov.br.(VR.nr.)1871/1999, të datës 15 mars 1999. Kjo kontratë pretendohet se është lidhur në mes të NPB-së dhe BDP-së për pronën e kërkuar;
  - Letërnjoftimin e paraqitëses së kërkesës nr. 2212968915082, të datës 19 korrik 2001;
  - Vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore HPCC/D/128/2004/C (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKP-së), të datës 18 qershor 2004, [Sipas këtij vendimi kërkesa e BDP-së (DS302533) për ri-posedimin e pronës së kërkuar (prona e njëjtë si në kërkesën KPA31478 para AKP-së) ishte refuzuar];
  - Letërnjoftimin e BDP-së nr. 2209967910043, të datës 1 gusht 2004;
  - Autorizimin OV.br.(VR.nr.)I b 10379/2008, të datës 29 dhjetor 2008. Ky dokument paraqet se BDP-ja kishte autorizuar këshilltarët ligjorë Ss.Z. dhe M.J., që të dy këta nga Këshilli Danez për Refugjatë “Danish Refugee Council (DRC), për të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore, në mes tjerash për ta përfaqësuar atë para AKP-së në lidhje me pronën e kërkuar;
  - Certifikatën e lindjes të paraqitëses së kërkesës nr. 200-1-15182/2012-09, të datës 4 korrik 2012, të lëshuar nga Republika e Serbisë;
3. Më 9 janar 2008, AKP kishte bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një shenjë në derën e banesës së kërkuar. Rezultoi se në kohën e njoftimit S.H. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë) ishte i pranishëm në pronë. Ai fillimisht kishte nënshkruar njoftimin mbi pjesëmarrjen dhe nuk kishte kërkuar të drejtën ligjore ndaj banesës së kërkuar por pastaj

në formë të përgjigjes në kërkesë dhe në deklaratën e tij të bashkangjitur thekson se ai jeton në banesën e kërkuar bazuar në vendimin e NPB-së.

Për të mbështetur pretendimin e tij, pala përgjegjëse në kërkesë kishte dorëzuar *inter alia* dokumentet vijuese:

- Vendimin e ndarjes nr. 01-1873/1, të datës 6 dhjetor 1999, lëshuar nga NPB-ja. Sipas këtij dokumenti banesa e kërkuar i është ndarë palës përgjegjëse në kërkesë për një shfrytëzim të përkohshëm gjashtë (6) mujor (nga data 10 dhjetor 1999 deri më 10 qershor 2000);
- Vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore HPCC/D/128/2004/C (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPB-së), të datës 18 qershor 2004. Në këtë vendim KKPB e kishte refuzuar kërkesën e kategorisë C të paraqitësit të kërkesës (BDP-së pranë AKP/KKPK). Kërkesa kishte të bënte me ri-posedimin e pronës së njëjtë, e cila është çështje lëndore e kërkesës KPA31478 të paraqitur në AKP. KKPB në vendimin e saj argumenton se nuk ishte e mundur të verifikoheshin dokumentet e prezantuara nga paraqitësi i kërkesës (BDP).
- Deklaratën e palës përgjegjëse në kërkesë, të datës 18 janar 2008;
- Pasaportën e palës përgjegjëse në kërkesë nr. K00560492, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës më 16 nëntor 2009;
- Deklaratën e palës përgjegjëse në kërkesë, të datës 3 dhjetor 2013 (dorëzuar në AKP më 19 dhjetor 2013).

4. Sipas Raportit të verifikimit të AKP-së të datës 15 tetor 2008 dhe Raportit të verifikimit të datës 1 korrik 2011, Vendimi i ndarjes dhe Kontrata mbi qiramarrjen nuk ishin gjetur në NPB. NPB zyrtarisht ka konstatuar se për sa i përket banesës së kërkuar ekzistojnë dokumentet në emër të M.R. (dhe jo në emër të BDP-së apo paraqitëses së kërkesës).
5. Më 13 mars 2014 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/C/231/2014, e ka refuzuar kërkesën e paraqitëses së kërkesës. Në paragrafin 93-95 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 25 prill 2014 zbatohet veçanërisht ndaj kërkesës, theksohet se Vendimi i ndarjes, Kontrata mbi qiradhënien dhe Kontrata e shitblerjes të dorëzuara nga paraqitësja e kërkesës nuk janë verifikuar si të vërteta

nga Sekretaria Ekzekutive. Gjithashtu, vendimi i njëjtë konstaton se paraqitësja e kërkesës nuk ka dëshmuar ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar.

6. Vendimi i ishte dorëzuar paraqitëses së kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) më 7 maj 2014 ndërsa ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme një ditë më vonë – më 8 maj 2014. Pala përgjegjëse në kërkesë (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) ka pranuar vendimin më 15 maj 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

7. Pala ankuese thekson se vendimi i KKKP-së përmban gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së zbatuar materiale apo procedurale.
8. Pala ankuese thekson se ajo nuk pajtohet me asnjë pjesë të vendimit të KKKP-së sepse ai është mbështetur në dokumentet që datojnë nga viti 1999 dhe nuk ka marrë parasysh dokumentet e vitit 1996 të dorëzuara nga ajo. Gjithashtu ajo thekson se prona e kërkuar i ishte ndarë burrit të saj në vitin 1966.
9. Pala ankuese thekson se një person tjetër me emrin M.R. më herët kishte jetuar në pronën e kërkuar. Këtij personi i ishte miratuar kërkesa për një banesë më të madhe. Pala ankuese shton se “ata” kishin marrë pronën e kërkuar dhe kishin jetuar aty për 15 vite “deri në kohën e bombardimeve”.
10. Në fund, pala ankuese propozon që t’i mundësohet atij blerja e pronës së kërkuar në mënyrë që ai të mund të paguaj për të.

### **Arsyetimi ligjor**

11. Ankesa është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.
12. KKKP e kishte mbështetur vendimin e vet mbi faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe KKKP kishin bërë një verifikim negativ të dokumenteve në të cilat pala ankuese

“kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin”. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka qenë në gjendje të siguroi *ex officio* asnjë provë që do të mbështeste kërkesën e palës ankuese. Bazuar në këtë, KKPK konstatoi se pala ankuese “nuk e ka dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar”.

13. Ankesa e palës ankuese përsërit pretendimet e njëjta që ajo i kishte bërë para KKPK-së. Me ankesën e saj ajo nuk kishte dorëzuar prova të reja.
  
14. Prona e njëjtë ishte çështje lëndore e kërkesës së BDP-së (Z.B.) për ri-posedim nr. DS302533, të dorëzuar në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banësore/Vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore (HPD/HPCC). Në fakt, KKPB në vendimin e saj nr. HPCC/D/128/2004/C, të datës 18 qershor 2004, kishte refuzuar kërkesën e BDP-së (bashkëshortit të palës ankuese para AKP-së/KKPK). KKPB kishte mbështetur vendimin e saj në faktin se asnjëri nga dokumentet të prezantuara nga BDP (Paraqitësi i kërkesës para DÇPB/KKPB) nuk ka origjinalin përkatës apo kopjen apo ndonjë referencë në regjistrat e bartësve përkatës të së drejtës së ndarjes, NPB, gjykatën komunale kompetente ose në ndonjë zyrë tjetër publike. Gjykata Supreme konsideron se për sa i përket kërkesës së palës ankuese të paraqitur në KKPK për ri-posedimin e pronës së kërkuar, vendimi i përmendur i KKPB-së paraqet *res judicata*. Megjithatë, edhe në situatë hipotetike nëse e drejta e BDP-së për ri-posedim nuk do të ishte pjesë e vendimit të KKPB-së, e drejta e pretenduar e palës ankuese për ri-posedim si dhe çdo e drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar nuk dëshmohej me asnjërin nga dokumentet e dorëzuar.
  
15. Për sa i përket pretendimit të palës ankuese se vendimi i KKPK-së mbështetet vetëm në dokumentet e vitit 1999 dhe jo në ata të vitit 1996, Gjykata konstaton se kjo nuk qëndron. Kjo së pari është për shkak se dokumentet në të cilat pala ankuese thekson se i mbështet të drejtat e tij të pretenduara janë dokumente të vitit 1999 (Vendimi i ndarjes, Kontrata e qiradhënies dhe Kontrata e blerjes), ndërsa së dyti dokumentet e vitit 1996 (Certifikata e kurorëzimit dhe Lista e renditjes) të prezantuara nga ajo (pala ankuese) nuk do mund të shërbenin si bazë për të mbështetur të drejtat e pretenduara.

16. Për sa i përket kërkesës së palës ankuese në ankesën e saj, për t'ia mundësuar asaj blerjen e pronës së kërkuar në mënyrë që ai të mund të paguaj për të (edhe pse në KKPK ajo kishte dorëzuar kontratën e blerjes në bazë të së cilës prona e kërkuar gjoja ishte blerë), Gjykata konsideron se përgjigjja nuk mund të jetë pozitive pasi që kjo bie jashtë mandatit të saj (kjo bie edhe jashtë mandatit të KKPK-së si organ i vendimmarrjes në shkallë të parë).
17. Gjykata Supreme konstaton se KKPK ka marrë një vendim të drejtë të mbështetur në një procedurë të plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike siç pretendohet nga pala ankuese. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
18. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**